



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI**  
**REGULATORNI URED ZA ENERGIJU**  
**ENERGY REGULATORY OFFICE**



**Prishtinë, 12 tetor 2022**  
**Kodi i ZRRE-së: V\_1604\_2022**

**Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,**

**Bazuar në:**

- Dispozitat e Nenit 9, paragrafi 1, nën paragrafi 1.7, Nenit 25, Nenit 26 paragrafi 1, nën paragrafi 1.2, të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 05/L-084),
- Dispozitat e Nenit 8 të Ligjit për Energjinë (Ligji Nr. 05/L-081),
- Dispozitat e Nenit 7 par. 7.3.6 dhe 7.4 të Rregullës dhe Metodologjisë për Përgatitjen e Bilanceve Elektrike dhe Termike Nr. 03/2020, dhe
- Kërkesën e Operatorit të Sistemit të Transmisionit dhe Tregut (KOSTT Sh.A) të datës 28.09.2022 për derogim të dokumenteve Bilanci Afatgjatë i Energjisë Elektrike dhe Plani i Adekuacisë së Gjenerimit,

**në seancën e mbajtur me datë 12 tetor 2022, nxori këtë:**

## **V E N D I M**

- I. REFUZOHET** - kërkesa e KOSTT SH.A. për *Derogim Bilanci Afatgjatë i Energjisë Elektrike dhe Plani i Adekuacisë së Gjenerimit.*

## **A R S Y E T I M**

- o Me datë 28.09.2022 KOSTT SH.A. ka dërguar në Zyrën e Rregullatorit për Energji (ZRRE) kërkesën për derogim për hartimin e dokumenteve Bilanci Afatgjatë i Energjisë Elektrike dhe Plani i Adekuacisë së Gjenerimit.
- o Sipas dispozitave ligjore të Nenit 8 par. 9 të Ligjit për Energjinë Nr. 05/L-081 është definuar që duhet të përgatitet Bilanci afatgjatë i energjisë miratohet për një periudhë dhjetë (10) vjeçare, ndërsa azhurnimet e bilancit afatgjatë të energjisë miratohen çdo (2) vjet.
- o Poashtu, me Rregullën Nr. 03/2020 për përgatitjen e Bilanceve Elektrike dhe Termike të miratuar nga Bordi i ZRRE, është përcaktuar që duhet të përgatitet bilanci afatgjatë për energji elektrike për periudhën dhjetë (10) vjeçare dhe azhurnimet e tij duhet të miratohen çdo dy (2) vite, dhe Plani i adekuacisë (mjaftueshmërisë) së gjenerimit, i cili është i obligueshëm të hartohet sipas Kodit të Rrjetit respektivisht neni 9 të Kodit të Planifikimit.

Prandaj, KOSTT SH.A., është e obliguar që sipas kërkesave ligjore të përshkruara në Rregullën dhe Metodologjinë për përgatitjen e Bilanceve të Energjisë Elektrike dhe Termike, të hartoj Bilancin



Afatgjatë të Energjisë Elektrike dhe Planin e Adekuacisë së Gjenerimit.

- o Bazuar në Metodologjinë për përgatitjen e Bilanceve të Energjisë Elektrike, KOSTT, dërgon pyetësorët tek palët relevante për të dhënat me të cilat përgatiten dokumentet strategjike të KOSTT.
- o Nga Ministria e Ekonomisë është kërkuar shtyrja e procesit të përpilimit të dokumentit Bilanci Afatgjatë i Energjisë Elektrike për shkak të pamundësisë së dërgimit të skenarëve përfundimtar të gjenerimit me arsyetimin se Strategjia e Energjisë së Republikës së Kosovës është ende duke u punuar si draft për dërgim në Qeveri dhe më pas në Kuvend për miratim.
- o Bordi i ZRRE-së, pas shqyrtimit, analizimit të kërkesës së KOSTT për derogim të përgatitjes së Bilancit Afatgjatë të Energjisë Elektrike dhe Planit të Adekuacisë së Gjenerimit, ka vlerësuar se kërkesa është e pabazuar ligjërisht, andaj ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.

III. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi, palët e pakënaqura mund ti drejtohen Gjykatës Kompetente brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

**Bordi i ZRRE-së,**

  
Ymer Fejzullahu, Kryesues

  
Selman Hoti, anëtar

  
Izet Rushiti, anëtar

  
Lutfije Dervishi, anëtar

  
Gani Buçaj, anëtar

Vendimi iu dërgohet palëve:

- KOSTT Sh.A.
- Arkivit të ZRRE-së.